



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 2611 Prot.

Tiranë, më 04.10.2021

VENDIM

Nr. 06, datë 01.10.2021

“Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Posaçme të Universitetit të Tiranës “Mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve *on line* të sezonit të dimrit të vitit akademik 2020-2021”

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 40 dhe në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 36, në mbledhjen e datës 01.10.2021, Rektorati i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren e Posaçme të UT-së, “Mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve *on line* të sezonit të dimrit të vitit akademik 2020-2021”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) Në titullin e Rregullores, në nenin 1 dhe në nenin 3, shprehja “2020-2021”, bëhet “2021-2022”.
- b) Në nenin 4, pika 4, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi:

Për evidentimin e njohurive të përfuara, gjatë procesit të kontrollit të dijeve, studenti duhet të paraqitet me pamje “imazhe-video” (video call). Regjistrimi për efekt të vlerësimit të njohurive si dhe të ndjekjes së procedurave të ankimimeve të mundshme, sipas përcaktimeve në nenet 50 dhe 51 të Rregullores së UT-së, do të ruhet për 21 (njëzetë e një) ditë.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtoria e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave, pranë Rektoratit të UT-së.
3. Vendimi t’u përcillet të gjithë njësive përbërëse për zbatim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Dr. Artan Hoxha